



I/E dashur lexues/e,

Je duke shfletuar numrin e pestë të buletinit INNOVET Albania, por njëherazi si në çdo botim të deritanishëm, je edhe dëshmitar i fryteve dhe arritjeve të më tepër se 7 viteve përkushtim, punë dhe pafund netë pa gjumë të një skuadre të madhe zemrash dhe sipërmarrësish të cilët punuan fort dhe besuan në misionin e Albanian Skills në drejtim të Arsimit dhe Formimit Profesional për Shqipërinë tonë të dashur.

Quhem Arlinda Baçi, në profesion Inxhinieri Ndërtimi, sot sipërmarrëse në biznesin tonë familjar në sektorin e stampimeve serigrafike dhe botimeve, me seli në qytetin magjepsës të Durrësit. Gjithashtu, bashkëthemeluese dhe anëtare e bordit ekzekutiv të Albanian Skills. Në Shkurt të vitit 2015 e përqafova ëndrrën e bukur të Anës për t'ju dhënë fëmijëve tanë dhe brezave që vijnë një instrument real dhe formues në rrugën drejt jetës; një instrument ndihmës për të gjetur dhe forcuar dritën e madhe që mbartin brenda vetes.



Arlinda Baçi

Shihni përreth jush. Me zhvillimin e hovshëm të teknologjisë çdo gjë po ndryshon, madje tashmë ka ndryshuar në mënyrë radikale mendësia e kontributit edhe e punës. Çdo gjë është e mundur! Mjafton që ti vetë ta dëshirosh dhe të kesh mjaftueshëm vullnet t'i përkushtohesh me punë dhe dije qëllimit tënd. Ti sigurisht që do të jesh punonjësi model dhe shembulli i grupit tënd të punës po aq sa mund të jesh edhe sipërmarrësi, udhëheqës projekti i cili zgjedh bashkpuntorët e tij. Ki besim tek vetja dhe dijet e tua. **Mos rresht së aftësuari mendjen: tani është koha jote për të sjell ndryshim!** Puna dhe përkushtimi kanë sjellë dhe gjithmonë e do të sjellin veç kënaqësi dhe arritje.

Arlinda Baçi
 Bashkëthemeluese dhe Anëtare e Bordit Ekzekutiv të Albanian Skills - NASC Shoqata Kombëtare e Aftësive Shqiptare

Rubrikat e Innovet Albania - Publikimi i Pestë

Ky publikim u përgatit dhe u editua nga: Fatma Memalli & Danja Zoto



Allbanian Day of Girls in ICT Këtë vit, në 10-vjetorin e kësaj iniciative globale edhe Albanian Skills ndër morri nismën "Albanian Day of Girls in ICT", duke ju bashkuar në këtë mënyrë përpjekjeve mbarëbotërore për të mbështetur fuqimisht vajzat në TIK.	Girls Way in Tech, një komunitet online për fuqizimin e vajzave në Teknologji Intervistë me Albina Peposhin. Girls Way in Tech është një komunitet online që synon të ndihmojë në mbylljen e hendekut gjinor duke nxitur sa më shumë vajza drejt teknologjisë, duke i fuqizuar dhe mbështetur ato me burime, kurse të ndryshme, seanca kodimi...	Të njohim partnerët tanë të INTERVET WB Në këtë rubrikë të buletinit të sotëm do të udhëtojmë drejt Bosnje-Hercegovinës dhe do të njihemi nga afër me IUS Lifelong Learning Center dhe Universitetin Ndërkombëtar të Sarajevës (IUS).
Dëshmi nga Vajzat pjesëmarrëse në Javën "Albanian Day of Girls in ICT" Dëshmi nga Isabela Tabaku, Lura Shehu dhe Albesja Berisha mbi përvojën e tyre përgjatë gjithë aktiviteteve të mbajtura në këtë javë.	Arsimi dhe Formimi Profesional nga këndvështrimi i studentëve të AFP-së Njihuni me dëshmitë e dhëna nga Klea Bërmeta, nxënëse në Shkollën Profesionale "Hermann Gmeiner" dhe Aishe Celami, nxënëse në Shkollën Profesionale në Kamëz.	BrainCamp - Një rrugëtim unik drejt Neuroshkencës Dëshmi nga Fabian Pirra dhe Sabjan Haska mbi përvojën e tyre përgjatë BrainCamp.

ALBANIAN DAY OF GIRLS IN ICT


Artikull nga Stafi i Albanian Skills

Teknologjia po bëhet pjesë e pandashme e jetëve tona, duke nisur që nga pajisjet më të përdorshme që tanimë janë pjesë e zakonshme e përditshmërive tona, e duke u shtrirë në mënyrë të gjithanshme në sektorin e shërbimeve apo në shumëllojshmërinë e industrive të ndryshme që operojnë sot. Teknologjia po prodhon mundësi të pafundme punësimi në tregun e punës, e megjithatë hendeuku gjinor në këtë sektor nuk është shuar ende. Sipas të dhënave të një studimi global të realizuar në vitin 2020 mbi fushën e programimit dhe të zhvillimit të programeve kompjuterike, shumica dërrmuese e këtij sektori përbëhet nga burrat me rreth 91.5% të të gjithë të anketuarve. Dita Ndërkombëtare e Vajzave në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është një iniciativë e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), pikërisht për të zbutur dhe për të kapërcyer këtë hendeq të theksuar gjinor ndërmjet ndërgjegjësimit dhe fuqizimit të vajzave për të konsideruar një karrierë të ardhshme në TIK.



Këtë vit, në 10-vjetorin e kësaj iniciative globale edhe Albanian Skills ndërmorri nismën "Albanian Day of Girls in ICT", duke ju bashkuar në këtë mënyrë përpjekjeve mbarëbotërore për të mbështetur fuqimisht vajzat në TIK. Falë bashkëpunimit të ngushtë me Universitetin Polis, Smart Center, EasyPay dhe Shkollën Profesionale TIK "Hermain Gmeiner", kjo nismë u bë realitet. "Albanian Day of Girls in ICT" u konceptua në mbajtjen e një jave të mbushur me aktivitete dhe sesione trajnuese ditore për vajzat pjesëmarrëse të cilat kulmuan në datën 22 Prill. Që në nisje të këtij rrugëtimi, u vërejt një interes i jashtëzakonshëm nga vajzat për t'ju bashkuar kësaj nisme, duke shënuar në total 160 aplikime të vajzave të grupmoshës 14 – 19 vjeç, me një shpërndarje të gjerë gjeografike në shumë zona dhe qytete të Shqipërisë.

Rrugëtimi i ketyre aktiviteteve nisi në datën 16 Prill dhe për 3 ditë me rradhë pjesëmarrëset ndoqën "Kampin e Aftësive Digjitalë" nepermjet disa sesioneve të trajnimit mbi tematikat: Krijimi i një aplikacioni përmes programit Glide, krijimi i një databaze, faqeje uebi me programet weebly dhe ndërmjet programimit, këshilla nga përvoja e një M Dezaigner Grafik, menaxhimi i projekteve dhe i rrjeteve sociale, nën udhëheqjen dhe mentorimin e trajnerëve: Kleona Elezi, Fatjona Lorja, Sindilajda Gjipali, Kristi Janku, Albina Toçilla dhe Mirela Murati. Pas ditëve intensive të trajnimit, vajzat pjesëmarrëse krijuan punimet individuale për dy ditë me rradhë të cilat u prezantuan nepermjet një "Panairi Virtual" gjatë eventit përmbyllës të kësaj nisme me prezencën dhe fjalën përshëndetëse nga: Ana Zacharian nga Albanian Skills, Albina Peposhi, një vajzë e re në teknologji, Linda Shomo nga EasyPay, Estela Bulku nga UN Women, Alma Stana nga Smart Center, Flutura Xhabija nga SHGPAZ, Eralda Ribaj nga Universiteti Polis dhe Elda Coxhaj nga Bashkia e Patosit. Eventit kulmoi me panairin virtual të punimeve dixhitale që vajzat kishin përgatitur nga ku Klaudia Meha dhe Ejona Xhaferi u përzgjodhën nga Universiteti Polis si fitueset e Bursës së Inovacionit. Në përmbyllje të të gjithë kësaj nisme, 95% e vajzave pohuan se kjo ishte një përvojë tejet e vlefshme për to, në të cilën aftësitë e tyre në TIK janë pasuruar si edhe interesi për të vijuar një karrierë të ardhme në këtë profil është rritur. Në përmbyllje të këtij rrugëtimi jemi tejmas të lumtur që mundëm të nxisnim e të mbështesnim sadopak ëndrrat dhe vizionet e vajzave për të ardhmen e tyre.



Panairi Virtual i Punimeve Dixhitale



Dëshmi nga Vajzat pjesëmarrëse në Javën "Albanian Girls in ICT"



Isabela Tabaku

Më duhet të them që kalova një kohë mjaft të bukur! Pasditet e mia duke filluar nga ora 17:00 e duke vijuar me mbrëmjet deri në orën 21:00 qenë mjaft të këndshme, mbushur me trajnime, biseda, njohuri dhe eksperiencë të reja. Më duhet t'ë theksoj që ishte pjesëmarrja e parë për mua në një event të tillë. Sesionet e zhvilluara online qenë mjaft të arrira kjo falë përkushtimit që treguan trajnerët, praninë e të cilëve e ndjeva si të ishin mësueset e mia. Marr shkas t'a them këtë për arsye të një komunikimi mjaft komod dhe modest që ato realizonin me ne. Falë njohurive që mora në këto orë trajnimi niveli i siguri dhe i përvetësimit të njohurive të mia është rritur. Ndër sesionet trajnuese shumë interesante që zhvluam ishte ajo me trajnerin Kristi Janku. Gjatë kësaj ore e imagjinova veten si një dizajnere të ardhshme. Dua të falënderoj përzemësisht organizatorët e këtij eventi, të gjithë trajnerët dhe ekipin e Albanian Skills.

Faleminderit që i afroni më tepër vajzat rreth teknologjisë!

Faleminderit që edukoni shtyllat e kësaj shoqërie!



Albesja Berisha

Përshëndetje lexues të Buletinit INNOVET Albania! Dua të ndaj me ju eksperiencën e këndshme që kalova gjatë javës së "Albanian Girls in ICT" të organizuar nga AlbanianSkills. Do ta përshkruaja këtë përvojë si një mundësi për të zgjeruar njohuritë në fushën e teknologjisë duke ndier energjinë pozitive dhe gjithëpërfshirjen në çdo moment. Te gjithë e dimë tashmë se bota ka marrë kahun e saj drejt teknologjisë, ku përveç digjitalizimit synohet një përmirësim i efektivitetit të ndërveprimit njeri-teknologji. Për vetë natyrën e saj diverse teknologjia i ofron mundësinë çdokujt të gjej veteveten në një nga fushat e saj. Të jesh një dizajner i mirë, një programues, një dizejner website-sh, menaxhues projektesh apo të bësh ndërlidhjen mes botës së teknologjisë dhe botës së biznesit.

Këto ishin edhe temat që trajtuam gjatë kësaj jave ku informacionet e marra ishin te qarta dhe tepër të vlefshme e të shpjeguara nga lektorë që punonin me pasion dhe nxitën edhe tek ne dëshirën për fushën e teknologjisë si një mënyrë për fuqizimin e vajzave. Pavarësisht barrierave që takimet online mund të ngrenë në aspektin e ndërveprimit me njëri-tjetrin, unë arrita të merrja shtysën e duhur për karrierën që aspiroj në të ardhmen dhe të njihesha me bashkëmoshatare të mijat, por dhe me profesioniste që punojnë fort për ëndrrat dhe qëllimet e tyre.



Lura Shehu

"Unë jam Lura Shehu nga qyteti i Durrësit. Jam 12 vjeç dhe studioj në Shkollën "Vincenc Prendushi". Ndoshta isha vajza më e vogël pjesëmarrëse në Javën "Albanian Girls in ICT". Kjo përvojë më mësoi se vajzat, si në shumë fusha të jetës, janë të zonjat dhe në TIK.

Falë kësaj nisme mësova që, **"kur vajzave u ofrohen mundësitë e duhura, pasioni mund të bëhet realitet me shumë lehtësi".**

Dëshmi nga Vajzat pjesëmarrëse në Javën "Albanian Girls in ICT"



Albina Peposhi

Girls Way in Tech, një komunitet online për fuqizimin e vajzave në Teknologji

1. A mund të prezantoheni shkurtimisht për lexuesit e Buletinit INNOVET Albania?

Unë jam Albina Peposhi, një gjimnaziste 17-vjeçare. Pjesën më të madhe të kohës e shpenzoj duke studiuar rreth teknologjisë dhe shkencës, duke lexuar libra, duke bërë sport dhe duke mësuar gjuhë të huaja. Kodimin e kam nisur në moshën 12 vjeçare pasi më dukej vërtet interesante. Sa më thellë zhytem në botën e programimit, me aq më shumë sfida përballem dhe janë pikërisht këto orë që kaloj duke zgjidhur problematikat e ndryshme që më pëlqejnë më se shumti. Natyrisht, të mësosh në mënyrë autodidakte do të thotë se ndonjëherë të mungon motivimi për të vazhduar, orët vonë përgjatë mbrëmjes para laptopit janë të lodhshme, por pjesëmarrja në evente të ndryshme dhe mbajtja e ekuilibrit me aktivitete të tjera më ka ndihmuar të ndërtoj disiplinën dhe formësoj mendësinë time.

2. Si filloi rrugëtimi juaj drejt TIK-ut? A mund të na tregoni diçka më shumë për rrjedhën e këtij rruëtimi, për sfidat dhe arritjet që e kanë shënuar atë?

Kam qenë gjithnjë e interesuar rreth teknologjisë. Kur isha më e vogël kaloja shumë kohë në laptop duke u përpjekur të kuptoja se si funksiononte. Sidoqoftë, gjithçka filloi 5 vite më parë, në një bisedë e sipër me motrën time rreth informatikës, dhe ajo më dërgoi një link të një kursi online në HTML. E nisa kursin atë ditë dhe m'u duk vërtet intriguese se sa lehtë mund të ndërtohen faqet e internetit. Pas kësaj, fillova të mësoj edhe programe të tjera (si CSS dhe JS). E vazhdova duke ndërtuar faqe të vogla në internet dhe në moshën 15 vjeç fillova të mësoj C ++ dhe Python. Në klasën e 9-të morra pjesë dhe fitova Olimpiadën e Informatikës në Durrës. Një vit pas kësaj, unë fitova Olimpiadën Kombëtare në Informatikë. Jam kualifikuar edhe këtë vit, por për shkak të pandemisë Olimpiadat janë shtyrë.

Gjatë pandemisë shumë evente u realizuan online dhe kjo më dha mundësinë për të marrë pjesë në një pafundësi trajnimesh. Në fund të vitit të kaluar bëra një trajnim 2 mujor rreth Inxhinierisë së Softuerit, ku kam punuar me Amazon Web Services dhe MERN Stack. Trajnimi ishte vërtetë sfidues, pasi kaloja të paktën 10-12 orë në ditë duke koduar, krahas shkollës. Pas kësaj ndoqa për katër javë 42Heilbronn - një shkollë kodimi (universitet) në Gjermani. Ky qe një muaj tjetër i kaluar duke koduar rreth 14 orë në ditë dhe të qenit pjesëmarrësja më e re në moshë ishte ndoshta sfida më e madhe atje. Muajin e kaluar fillova të punoj si full-stack developer me kohë të pjesshme për një kompani amerikane. Tani jam përqendruar tek shkolla, puna dhe disa projekte të tjera anësore.

3. Si është të jesh një vajzë e re e suksesshme në fushën e TIK-ut? A përballen vajzat me pengesa që lidhen me statusin e tyre gjinor dhe si mund të rritet numri i vajzave që zgjedhin të ndjekin një karrierë në fushat STEM / TIK?

Të punosh në fushën e TIK-ut nuk është e lehtë në radhë të parë dhe pastaj të jesh vajzë është edhe më e vështirë. Programimi kërkon shumë përkushtim, përqendrim dhe orë të gjata pune. Vajzat përballen me pengesa kryesisht sepse kur thua "Unë jam një programuese" imazhi i parë që vjen në mendje është ai i një djali që shkruan shpejt në një tastierë përballë një ekrani të zi në një dhomë të errët. Me këtë dua të them se është mentaliteti i njerëzve - ata mendojnë se programimi është punë për djem. Vazhdimisht më pyesin me habi "ti je vajzë dhe kodon?" ose "vajzat mund të kodojnë?" dhe këto nuk janë të këndshme për t'u dëgjuar. Gjatë bisedave që kam zhvilluar me disa profesioniste, të cilat i kam njohur përgjatë disa eventeve, gjithmonë flitej për dy grupe të ndryshme të formuara në bazë të gjinisë dhe për faktin se si ato nënvlerësoheshin vazhdimisht e se si idetë dhe mendimet e tyre nuk merreshin në konsideratë. E vërteta është se vajzat përbëjnë ende një pakicë në TIK, vetëm 11% e programuesve në botë janë vajza, por kohët e fundit gjërat po ndryshojnë me shpejtësi dhe kjo është një shenjë e mirë, por vetëm kaq nuk mjafton. Ne nuk mund të bëjmë ndryshime domethënëse pa u bashkuar së bashku e duhet të dimë se veprat vlejnë më shumë se fjalët. Ne mund të krijojmë më shumë evente dhe komunitete për të ndarë përvojat dhe burimet me njëra-tjetrën. Më e rëndësishmja, duhet të zëvendësojmë mendësinë "teknologjia është fushë djemsh" në "teknologjia nuk ka moshë dhe gjini".

4. Ju keni krijuar një platformë shumë interesante për Vajzat në Teknologji. A mund të na tregoni më shumë rreth kësaj platforme?

Girls Way in Tech është një komunitet online që synon të ndihmojë në mbylljen e hendekut gjinor duke nxitur më shumë vajza drejt teknologjisë, duke i fuqizuar dhe mbështetur ato me burime, kurse të ndryshme, seanca kodimi së bashku, webinars ose evente të tjera që do të mbahen këtë verë. Mund të na gjeni në Instagram, Discord dhe së shpejti do të kemi dhe faqen tonë.

5. Si lindi ideja për të krijuar një platformë për vajzat në teknologji dhe çfarë synoni të arrini përmes kësaj platforme?

Ideja lindi fillimisht nga motra ime, Brigitte Peposhi. Disa vite më parë, teksa u informua më shumë për këtë hendek gjinor dhe pabarazi në TIK, ajo inicioi idenë e krijimit të një platforme për të frymëzuar dhe motivuar vajzat, për t'i treguar atyre se janë të afta të bëjnë më shumë nëse i vendosin vetes qëllime ambicioze dhe se nuk mund të përcaktoheni nga ajo që njerëzit e tjerë mendojnë se jemi në gjendje të arrijmë. Shembulli që na motivon më së shumti është fakti se programuesja e parë kompjuterike ishte Ada Lovelace - një grua. Qëllimi ynë kryesor është të krijojmë një komunitet ku të mund të rritemi së bashku dhe të punojmë në projekte të ndryshme, mund të flasim e të ndajmë përvojat tona. Kemi gjithashtu dhe disa djem në serverin tonë që mbështesin lëvizjen **Girls Way in Tech**. Kemi shumë punë para nesh, por jemi vërtetë krenarë që çdo gjë po shkon mirë.

6. Cili do të ishte mesazhi juaj i fundit për të gjithë lexuesit e buletinit dhe për të gjithë të rinjtë në Shqipëri?

Kur jeni të apasionuar pas diçkaje dhe kur doni vërtet ta realizoni atë, atëherë ndaloni së ëndërruari, zgjidhni dhe punoni fort, sepse të gjithë jemi të aftë të bëjmë gjëra të mëdha, pa marrë parasysh se çfarë thonë njerëzit rreth nesh. Në fund të ditës, perspektiva dhe mendimet tona kanë rëndësi dhe ne mund të arrijmë aq sa i vendosim vetes synim, kështu që sigurohuni t'i hiqni qafe kufijtë! Unë gjithashtu do t'ju këshilloja të kujdeseni mirë për trupin dhe mendjen tuaj, ushtrohuni dhe ushqehuni shëndetshëm sepse do t'ju duhen këto pasuri gjatë rrugëtimit tuaj.



Arsimi dhe Formimi Profesional nga këndvështrimi i studentëve të AFP-së



Klea Bërmeta

Përshëndetje të gjithë lexuesve të Buletinit INNOVET Albania!

Unë quhem Klea Bërmeta dhe studioj në Shkollën Profesionale "Hermann Gmeiner", përkatësisht në vit të dytë në profilin TIK. Pas përfundimit të shkollës 9-vjeçare isha mes dy "zjarresh": të vazhdoja arsimin e përgjithshëm si shumica e bashkëmoshatarëve të mi apo të drejtohesha drejt arsimit profesional. Hulumtova shumë në internet, pyeta shumë persona që e kishin kryer më parë një edukim të tillë, kërkoja se çfarë ishte më e mira për të ardhmen time dhe në fund arrita në vendimin final që më shtyu të trokisja në dyert e shkollës "Hermann Gmeiner".

Më parë kur mendoja rreth Arsimit Profesional dhe për më tepër rreth fushës së IT, gjëja e parë që më shkonte në mendje ishte një shkollë e mbushur vetëm me djem. Por ja që gabohesha, gjendeshin plot vajza ambicioze në shkollë. Ky fakt më bëri akoma më të lumtur e të bindur për vendimin që kisha marrë. Dikush mund të pyes se çfarë përparësish ka shkollimi në një shkollë profesionale nga shkollimi tipik në një gjimnaz të përgjithshëm që shpesh jemi mësuar të dëgjojmë. Po ju listoj disa asye:


- Së pari, arsimi profesional të jep mundësinë e zhvillimit të praktikave të shumta si në laboratorët brenda ambjenteve të shkollës, ashtu dhe në biznese partnere të siguruara nga shkolla. Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me vendet tona të ardhshme të punës. Nuk mungojnë as rastet kur shumë nxënës që trajnohen në keto biznese të fitojnë një vend pune paralelisht me studimet. Mundësia për t'u punësuar pas përfundimit të kësaj shkolle në gjykimin tim është shumë më e lehtë dhe e shpejtë. Pas këtij formimi profesional 4-vjeçar çdo nxënës ka krijuar CV-në e tij tashmë të tejmbushur të cilin mund ta paraqesë në vendin e punës së ëndërruar.
- Së dyti AFP të orienton në aftësitë që kërkon tregu i punës.
- Së treti dhe më e rëndësishmja nëpërmjet arsimit profesional ne përgatitemi për atë që na pret më vonë në jetë.

Bëhemi të aftë dhe të pavarur që në një moshë të hershme.

Dua të motivoj çdo vajzë që mendon se kodimi apo çdo drejtim tjetër që kanë dëshirë të ndjekin, është i papërshtatshëm për to e nuk ia vlen të studiohet, pasi shohin që kryesisht këto fusha kanë masivitet meshkujsh, se gabohen. Duhet të jemi pikërisht ne ato të cilat duhet ta ndryshojmë këtë pikëpamje të gabuar. **Nuk ka gjini që mund të përcaktojë nivelin e aftësisë në të mësuar e punuar.** Mund të ketë pafund vajza që i bëjnë më mirë të ashtëquajturat "punë djemsh".

Arsimi profesional është sinonim i fjalës inovacion. Këto shkolla janë burim i qindra ideve inovative duke u bazuar në kërkesat e tregut. Sot më shumë se kurrë tregu i punës ka nevojë për inovatorë. Studimet konfirmojnë se rreth 90% e bizneseve dëshirojnë të jenë më inovativë, duke theksuar se inovacioni është një prioritet për ta. AFP është gjatë gjithë kohës në progres, duke mos qenë kurrë i njëjtë dhe monoton. Për ta pëmbyllur, nëse do të kthehesha prapa në kohë e do të më duhet të zgjidhja mes arsimit të përgjithshëm e atij profesional, pa u menduar dy herë do të zgjidhja këtë të fundit. AFP më ka falur gjëra që besoj se shumë nga bashkëmoshatarët e mi nuk e kanë mundësinë t'i kenë. Të gjithë ju që gjendeni në dilemë si unë në fillim mos nguroni ta provoni, pasi nuk do të zgjënjeneni.

Përshëndetje! Quhem Aishe Celami. Jam 18 vjeç dhe banoj në qytetin e vogël të Vorës. Studioj ne Shkollën e Mesme Profesionale Kamëz në drejtimin T.I.K. (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi). Ishte pak e vështirë fillimisht të merrja vendimin përfundimtar për arsimin që do të ndiqja, pasi në zonën tonë nuk kishte shkollë profesionale. Bindjet e mia qëndronin gjithnjë e më tepër për arsimin profesional, pasi kisha dëshirë të përvetesoja një profesion dhe mundësinë për t'u lidhur më shpejt me tregun e punës. Dhe kështu gjeta mbështetje dhe një staf pedagogjik të mrekullueshëm në Shkollën Profesionale Kamëz. Shkolla ku unë studioj është e kompletuar me kabinete dhe pajisje të përshtatshme për një edukim profesional të mirëorganizuar. Pas marrjes së diplomës së parë në përfundim të vitit të dytë, na jepet mundësia për zhvillimin e praktikave nëpër biznese. Ndihej e kënaqur nga njohuritë që kam marrë përmes këtij arsimit dhe jam shumë e apasionuar për të vazhduar studimet dhe më tej duke zgjeruar horizontet e dijes në degën e IT. Kjo sepse është një degë e gjithanshme dhe inovative në ditët e sotme e cila premtan shumë për të ardhmen.



Aishe Celami

Dua t'u percjell një mesazh të gjitha vajzave që të mos hezitojnë të jenë pjesë e arsimit profesional, pasi aty do të gjejnë mundësi të pafundme për të hedhur bazat e suksesit në karrierën e tyre. **#BëhuDheTisiUnë.** Ti tregojmë botës që TIK përfaqësohet shumë mirë nga vajzat!



TË NJOHIM PARTNERËT TANË TË INTERVET WB

14
project partners

6
regional partners

8
EU member states

Në projektin INTERVET WB janë të përfshirë gjashtë partnerë rajonalë: Shqipëria, Bosnjë - Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Serbia, si dhe 8 partnerë nga shtetet anëtare të BE-së: Italia, Belgjika, Holanda, Franca, Malta, Spanja, Sllovenia dhe Polonia. Në këtë rubrikë të buletinit të sotëm do të udhëtojmë drejt Bosnje - Hercegovinës dhe do të njihemi nga afër me TUS Lifelong Learning Center dhe Universitetin Ndërkombëtar të Sarajevës (IUS).

Artikull i shkruar nga Mirsada Mehremic - Assistant Director LLC

IUSlife

56

PRO-type mobility

360

Mobilities

54

Job shadowing experiences

36

teachers in summer schools

Mirsada Mehremic



Të nderuar kolegë dhe të dashur lexues,


Jam vërtet e nderuar që jam ftuar nga ekipi i Albanian Skills për të dhënë kontributin tim në buletin tuaj dhe posaçërisht për të prezantuar Qendrën tonë të të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës dhe Universitetin Ndërkombëtar të Sarajevës (IUS). Universiteti Ndërkombëtar i Sarajevës është themeluar nga Fondacioni për Zhvillimin e Arsimit në Sarajevë në vitin 2004. IUS me 5 fakultetet e tij (Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave të Natyrës, Fakulteti i Arteve dhe Shkencave Sociale, Fakulteti i Biznesit dhe Administrimit, Fakulteti i Drejtësisë, dhe Fakulteti i Edukimit), 6 qendra drejtuese, 21 programe studimi dhe 19 programe pasuniversitare është një nga institucionet kryesore të arsimit të lartë në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe është emëruar universiteti privat më i mirë në vend.

Vizioni i IUS është të bëhet një institucion i njohur ndërkombëtarisht i arsimit të lartë dhe kërkimit dhe një qendër e përsosmërisë dhe cilësisë përmes përpjekjeve të përbashkëta të themeluesve, stafit akademik dhe administrativ, studentëve dhe të gjithë aktorëve të interesuar. Aktualisht në IUS studiojnë mbi 2000 studentë që vijnë nga 56 vende të ndryshme të botës dhe janë të punësuar më shumë se 200 anëtarë të stafit me kohë të plotë dhe personeli ynë është nga më shumë se 22 shtete të ndryshme.


Qendra e Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (IUS Life) e themeluar në vitin 2013 synon të ndihmojë zhvillimin personal dhe profesional përmes programeve të ndryshme. Për të krijuar një forcë punëtore të trajnuar më mirë dhe për të kontribuar në ekonominë e Bosnjë-Hercegovinës, trajnime të ndryshme profesionale, programe zhvillimi profesional dhe personal, kurse të gjuhëve të huaja dhe të njohurive kompjuterike, programe certifikatash dhe seminare mbahen nga IUS Life. Veçanërisht përmes programeve profesionale jofitimprurëse, IUS Life dëshiron të rrisë frymën e sipërmarrjes, për të hapur rrugë të reja për biznesin. Për këtë qëllim, IUS Life punon në bashkëpunim me të gjithë sektorin publik dhe privat dhe organet ndërkombëtare. Një pjesë integrale e IUS Life është Shkolla e Gjuhës Angleze (ELS) e akredituar nga Eqauals. Objektivi kryesor i (ELS) është siguri i një cilësie të lartë mësimi intensiv të Gjuhës Angleze për ata studentë që pranohen në IUS pa aftësitë e nevojshme gjuhësore. ELS është gjithashtu e hapur për kurse publike që ofrojnë versione të mësimdhënies tradicionale, online ose mësimdhënie të përzier. IUS / IUS Life është përfshirë në Erasmus +, Programin e Shkëmbimit Mevlana dhe merr pjesë në shumë projekte të financuara nga BE, USAID dhe agjencitë shtetërore.



BRAIN CAMP 2021 - Një rrugëtim unik drejt Neuroshkencës



BrainCamp është një projekt i iniciuar nga Egzona Morina dhe Fondacioni M & Xh. BrainCamp International është një kurs i gjatë një javor, ku studentët e doktoraturës nga universitetet më të mira në botë u mësojnë nxënësve të shkollave të mesme tematika të ndryshme lidhur me neuroshkencën. Këtë vit për herë të parë BrainCamp u zhvillua edhe në Shqipëri së bashku me disa vende të tjera evropiane. Qëllimi i BrainCamp është të frymëzojë të rinjtë të mendojnë për shkencën në një dritë të re dhe potencialisht ti motivojë ata që të investojnë kohën e tyre në një rrugëtim të ardhshme drejt kësaj fushe. Le të njihemi me dy nga pjesëmarrësit në BrainCamp Albania dhe me dëshmitë e tyre rreth kësaj përvojë.



Fabian Pirra

Quhem Fabian Pirra dhe jam 16 vjeç. Aktualisht jam nxënës në klasën e dhjetë. Për mua neuroshkenca është një degë e biologjisë e cila është sa e komplekse aq edhe e bukur. Neuroshkenca është fushë të cilën e shoh si një burim të gjerë informacioni për kuptimin dhe mësimin e funksioneve të trurit dhe sistemit nervor. Neuroshkencën e shikoj si burim dijeje që do të më ndihmojnë në të ardhmen, pasi dua të vazhdoj Universitetin e Mjeksisë dhe të specializohem më pas për Neurokirurgji. Synimi im është të bëhem një neurokirurg.

Brain Camp e pashë si një mundësi të artë për zgjerimin e dijeve të mia. Sa i përket përvojës ishte diçka tepër e veçantë dhe e bukur. Mësimdhënësit ishin të edukuar, gazmorë, mendjehapur dhe miqësorë. Çdokush do të kishte dëshirë të bënte mësim me ta. Ajo çka i dallon ata nga lektorët e tjerë është aftësia e tyre për të shpjeguar çështje të ndërlikuara, në mënyrën më të thjeshtë të mundshme. Ishte një eksperiencë e mrekullueshme nga e cila mora shumë informacione të vlefshme, që do të më ndihmojnë në formimin profesional për të ardhmen time. Gjatë Brain Camp aftësova dhe të menduarit kritik, ku nga të gjitha tematikat që shpjegoheshin duhet të dilja në përfundime logjike, gjithashtu duhet edhe të mbronim mendimet dhe idetë tona duke u bazuar në fushën e neuroshkencës. Me pak fjalë eksperiencia në Brain Camp ishte e veçantë dhe speciale. Ishte një eksperiencë aq mbresëlënëse sa që nëse Brain Camp do të bëhet përsëri vitin e ardhshëm, unë do të marr pjesë përsëri. Mesazhi që dua t'ju përcjell lexuesve është: "Kurrë mos hiqni dorë nga ëndërrat tuaja dhe shfrytëzoni çdo mundësi për realizimin e tyre" sepse me punë, vullnet dhe logjikë arrihet çdo gjë.

Sabjan Haska

Unë quhem Sabjan Haska, jam 15 vjeç dhe jam në klasën e nëntë. Vij nga qyteti i Gjirokastrës dhe studioj në Shkollën Jopublike "Frymë Dashurie". Në lidhje me neuroshkencën para eksperiencës time në BrainCamp nuk isha në dijeni dhe ishte diçka e panjohur për mua.

Me aq sa mësova rreth saj, neuroshkenca më duket shumë interesante dhe mendoj se është një fushë që do të ndikojë masivisht në zhvillimin e njerëzimit. Edhe pse kjo shkencë më pëlqeu shumë, për momentin jam më tepër i fokusuar në shkencën e matematikës në ndërthurje me artin pasi janë dy degë në dukje aspak të ngjashme, të cilat më tërheqin. Më pëlqen të studioj për arkitekturë në të ardhmen, por është ende shpejt për të vendosur, pasi ekzistojnë një larmishmëri degësh.

Eksperiencia ime në BrainCamp ishte një eksperiencë e veçantë që nuk e prisja realisht të ishte kaq mbresëlënëse. Fillimisht e konsiderova thjesht si një aktivitet mbi një fushë ku unë nuk kisha njohuri, thjesht sa për një eksperiencë më tepër. Por rezultoi të ishte një përvojë që nuk kam për ta harruar lehtë. Mësimdhënësit dhe mësimi në tërësi ishte sa interesant aq edhe argëtues. Edhe pse çdo gjë zhvillohej në gjuhën angleze, nuk pata asnjë vështirësi në kuptimin e informacionit të marrë. Mësova aq shumë gjëra për të cilat kisha pak ose aspak njohuri në jetën time të përditshme. Do të doja që të gjithë ata që nuk kanë marrë pjesë ende të mos ngurrojnë, pasi është një eksperiencë shumë e bukur. Ku nuk merr vetëm informacion mbi çka ke përreth, por argëtohesh pafundësisht me bisedat dhe shakatë që bëhen gjatë asaj ore të shkurtër mësimore. Nëse do të më jepej mundësia të merrja pjesë për herë të dytë do ta bëja me kënaqësinë më të madhe të mundshme.

